



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
AGJENCIA E PARQEVE DHE REKREACIONIT
DREJTORIA E PROKURIMIT PUBLIK

Data 04.09.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Sherbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “PASTRIMI I BASENEVE TË LIQENEVE NË PARQE”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
90733300-7 Shërbime të mbrojtjes ndaj ndotjes së ujit në sipërfaqe**

VLERA E FONDIT LIMIT:

6.000.000 (gjashtëmilion) lekë pa Tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8,*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 26 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; perkatesisht në vleren: 120.000 (njëqind e njëzetmijë)*

lekë pa Tvsh të lëshuar në formën e garancisë bankare ose nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020

“Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 30, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se:

“...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël...”

“...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe...”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 - Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë **Certifikatë ISO 9001** ose ekuivalentin, lidhur me sistemet e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Kjo certifikatë të jetë e lëshuar nga një organi i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO).

2.1.2 - Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë **Certifikatë ISO 14001** ose ekuivalentin, lidhur me sistemet e menaxhimit mjedisor, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Kjo certifikatë të jetë e lëshuar nga një organi i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO)

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

Vendosja e këtyre kriterëve është e bazuar në faktin që certifikatat ISO garantojnë që operatorët ekonomik zbatojnë në punën e tyre për realizimin e shërbimit objekt prokurimi procedura të certifikuar ndërkombëtare për të garantuar cilësi të shërbimit.

Përmbushja e standartit **ISO 9001:2015** është i rëndësishëm për të siguruar menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kërkohen. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe

zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë.

Përmbushja e standartit **ISO 14001: 2015** shërben për të verifikuar dhe garantuar që Operatori Ekonomik është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës, duke garantuar menaxhimin e mjedisit.

Ky lloj çertifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të mjedisit për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të menxhimit të mjedisor.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% vlerës e fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, sa 40 % vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik", i ndryshuar në të cilin përcaktohet se:

" 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës.

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse autoriteti jonë kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin ekonomik të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, njësia e prokurimit vendosi që të hartonte dhe përcaktonte këtë kërkesë për kualifikim.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur e thjeshtuar" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 43, pika 1 e 2 "Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare" të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar si dhe Kreut II "Kufijtë monetarë" të VKM nr. 291, datë 15.05.2024 "Për përcaktimin e kufijve monetare në procedurat e prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Neni 43

Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, ne procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...;

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.;

KREU II

KUFIJTË MONETARË NË SEKTORIN KLASIK

1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000 000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.

2. Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

Lidhur me vitet financiare për të cilat kërkohet që të jetë e realizuar xhiro e kërkuar, njësia e prokurimit duke ju referuar përcaktimeve të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 15.06.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku është përcaktuar se deklarata e xhiros vjetore mund të kërkohet deri në tre vitet e fundit financiare, si dhe nisur nga përcaktimi i pikës 7 të Rekomandimit të APP Nr.7998 datë 24.12.2021 "Mbi hartimin e kritereve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime" ku përcaktohet se në nenin 19 të ligjit nr 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, deklarata vjetore e të ardhurave nga subjektet tatim paguese deklarohet në organe tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, prandaj njësia e prokurimit meqënëse procedura e prokurimit do të zhvillohet në korrik të vitit 2024 dhe tatimpaguesit kanë afat deri më 31 mars 2024 të deklarojnë xhiron e realizuar në vitin 2023 përcaktoi si 3 (tre) vite të fundit financiare vitet 2021, 2022 dhe 2023.

Lidhur me vlerën e xhiros vjetore të përcaktuar, meqënëse procedura e mësipërme e prokurimit është nën kufirin e ulët monetar u përcaktua që vlera e xhiros vjetore të jetë sa 40% e vlerës së fondit limit.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i

ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Njësisë së Qeverisjes Vendore ku operatori ekonomik ka selinë.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. *Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 76, pika 2, gërma b të LPP, i ndryshuar si dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore“ i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2023 në të gjitha vendet ku ushtron aktivitet ekonomik sipas të dhënave të QKB-së.

2.3 Për kapacitetin teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate konkretisht: 1.200.000 (një milion e dyqind mijë) lekë pa Tvsh .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për shërbime të mëparshme të ngjashme të realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të ngjashme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në

fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4, germa (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të fondit limit për këtë lot. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

2.3.2 Numri mesatar i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më pak se **7 (shtatë) punonjës** për periudhën e **tre muajve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**. Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore/ose Administrata Tatimore për periudhën e **tre muajve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**.
- b) Listëpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e **tre muajve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**.

Shënim: kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE kualifikohet në vend të parë, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i punonjësve është përcaktuar duke u bazuar në afatin kohor të përcaktuar për të përmbushur zbatimin e kontratës si dhe në stafin e kualifikuar që duhet për realizimin e shërbimit. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë totale punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 7 (shtatë) persona është në përputhje me volumin e punës që do të kryhet, natyrën e shërbimit dhe terrenin ku do të kryhen

shërbimet. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik ofetues, për realizimin e shërbimit sipas kontratës objekt prokurimi, duhet të ketë të punësuar në stafin e shoqërisë së tij, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën e tre muajve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, stafin inxhinierik, si më poshtë:

1 (një) Inxhinier Mjedis.

1 (një) Inxhinier Agrar në Akuakulturë.

Lidhur me stafin e mësipërm inxhinierik, çdo Ofertues duhet të disponojë, si dhe duhet të paraqesë në tender, sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi, konkretisht: Kontratën e punës të vlefshme, librezën e punës, diplomën përkatëse.

Shënim: kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE kualifikohet në vend të parë, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe në nenin 41, pika 4, gërma b, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Referuar natyrës së shërbimeve që kërkohen të prokurohen sic është shërbim pastrimi i baseneve në liqene, kërkohet inxhinieri i mjedisit i cili organizon punën për marrjen e masave të nevojshme parandaluse me qëllim shmangien e demeve të ndikimit në mjedis gjatë realizimit të shërbimit si dhe gjatë grumbullimit të mbetjeve në breg të liqenit dhe transportimit të tyre. AK kërkon siguri që shërbimi do të kryhet në standartin e duhur. Në këtë kuadër inxhinieri Mjedisit, i cili është specialist i fushës, duhet të ndjekë shërbimin nga afër për t'i dhënë zgjidhje çdo problemi të mundshëm për një shërbim sa më cilësor. Domosdoshmëria e Inxhinierit të Mjedisit diktohet nga nevoja që shërbimi të kryhet në mënyrën e duhur dhe gjatë shërbimit mos të hasen probleme të cilat mund të ndikojnë negativisht në mjedis. Duke patur parasysh se kualifikimi profesional i inxhinierit të mjedisit përfshin kontrollin e ndotjes së ujit dhe ajrit, riciklimin, depozitimin e mbeturinave dhe mbrojtjen e ekosistemit në tërësi është konsideruar e nevojshme që operatorët ekonomik të kenë në stafin e tyre një inxhinier mjedis.

Gjithashtu duke pasur parasysh se objekti i kontratës përfshin edhe prerjen e barërave algave në sipërfaqe dhe thellësi dhe leshterikëve, për të mbrojtur mjedisin nënujor bimët nënujore dhe algat të nevojshme për ujërat e liqeneve është konsideruar e nevojshme që operatori ekonomik të ketë një inxhinier agrar në akuakulture.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, specifikimet dhe zërat e shërbimit që do të realizohen dhe do të monitorohen në vazhdimësi nga ky staf

2.3.4. Operatori ekonomik ofertues, për realizimin e shërbimeve sipas kontratës objekt prokurimi, duhet të ketë të punësuar në stafin e shoqërisë së tij dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën e tre muajve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, të paktën një inxhinier të diplomuar në inxhinieri mekanike/industriale, lidhur kjo me makineritë/pajisjet që kërkohen për realizimin e këtij objekti prokurimi.

Lidhur me inxhinierin e mësipërm, çdo ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e punës të vlefshme, diplomën përkatëse.

Shënim: kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE kualifikohet në vend të parë, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe në nenin 41, pika 4, gërma b, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion në kushte optimale teknike makinerine korrese për liqene me qëllim përmbushjen e kontratës. Makinaria është specifike dhe e nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Disponimi i mjetit në cdo kohë bëhet i mundur nëpërmjet asistencës teknike që operatori ekonomik ka në stafin e tij për mirëmbajtjen e këtij mjeti. Disponimi i inxhinierit mekanik është domosdoshmëri që lidhet me tipin e mjetit (makineri korrese për liqene) që nevojiten për realizimin e objektit të kontratës dhe në raport me afatin e kontratës. Për vet natyrën e kontratës, shtrirjes (vendndodhjes) dhe përmasave të objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët të kryejnë shërbimin e pastrimit dhe realizojnë objektin e kontratës me standardet e kërkuara të cilësisë. Në këtë kuadër mos realizimi në kohë dhe me cilësi i kontratës do të mund të përbënte jo vetëm një mos-realizim të detyrave kontraktuale por edhe një problem për interesin publik në tërësi, pasi do të rrezikohet procesi i pastrimit i rëndësishëm për mbarevajtjen e ekosistemit.

2.3.5 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/ certifikuar si:

- 1 (një) punonjes të disponojë çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", (i ndryshuar).

Shënim: kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE kualifikohet në vend të parë, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” : Aftësia profesionale e operatorëve ekonomik për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Kërkesa për një punonjës të certifikuar si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” bazohet në kërkesat e Ligjit Nr.10 237, dt 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” Njësia e prokurimit gjykon se për realizimin e shërbimit, me qëllim garantimin e sigurisë dhe

mbrojtjen e shëndetit, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksidenti si dhe në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni sektorial në fuqi, është e nevojshme prezenca e ekspertit për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në pasi ka shërbime që do të kryhen në brendësi të liqeneve.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues, për realizimin e shërbimit, duhet të ketë pjesë të stafit dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë me kodet përkatëse të punësimit, minimalisht tre muajt e fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, të paktën:

- 1(një) Specialist të zhytjes
- 1(një) pastrues mbetjesh ujore.

Shënim: kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE kualifikohet në vend të parë, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar: *Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës*” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Kriteri për stafin teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, specifikimet teknike dhe zërat e shërbimit. Nevoja për drejtues varke është e diktuar nga natyra teknike e shërbimit pasi në cdo rast për nevoja të ndryshme gjatë shërbimit të pastrimit mund të përdoren varkat. Specialist zhytje pasi mund të paraqiten probleme të ndryshme në thellësi gjatë pastrimit të basenit dhe pastruesi i mbetjeve ujore i cili do të realizojë gjithë pjesën teknike të grumbullimit të mbetjeve futjes së tyre neper thasë dhe të transportit. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e shërbimit. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. AK gjykon se të pasurit në dispozicion të stafit teknik sa më sipër, tregojnë besueshmëri për autoritetin kontraktor që, operatori do të përmbushë kontratën me efikasitet.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues, për realizimin e shërbimit, duhet të ketë pjesë të stafit të paktën 1 (një) punonjës të çertifikuar dhe trajnuar për drejtimin e mjeteve lundruese me motor, lëshuar nga institucione kompetente për të cilin duhet të paraqitet kontrata e punës (e vlefshme) për gjithë periudhën e realizimit të kontratës, deshmia e aftësisë për drejtim mjeti lundrues, çertifikata e trajnimit të kryer, për drejtimin e sigurtë të mjeteve të vogla lundruese me motor si dhe të figurojë në listpagesa për 3 (tre) muajt e fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Shënim: kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE kualifikohet në vend të parë, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar: *Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative,*

reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Gjithashtu në vendosjen e këtij kriteri autoriteti kontraktor është mbështetur dhe ne aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për mjetet lundruese në Ligjin Nr. 9251, 08.07.2004, Neni 37 “Regjistri i Mjeteve Lundruese Shqiptare”, Ligji 10109 “Për Administratën Detare të Republikës së Shqipërisë” Neni 12 , VKM Nr. 462, datë 09.07.2014 “Për Miratimin e Rregullores për Regjistrimin e Mjeteve Lundruese në Republikën e Shqipërisë”, Ligj Nr. 127/2020 datë 15.10.2020 “ Për Regjistrimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese turistike dhe të argëtimit si dhe VKM –së Nr. 462 datë 09.07.2014 “ Rregullore për regjistrimin e mjeteve lundruese “.

2.3.8 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike

Kandidati/Operatori ekonomik ofertues, ofertues duhet të disponojë minimalisht pajisjet dhe mjetet e mëposhtme dhe pajisjeve mbrojtëse në punë të punonjësve, për kryerjen e shërbimit me qëllim realizimin e objektit të prokurimit, si më poshtë:

<i>Mjetet/Pajisjet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion me vinç me kapacitet mbajtës 3-3.5 ton	1 copë	Pronësi ose me qira
Minieskavator	1 copë	Pronësi ose me qira
Makineri pastrimi për sipërfaqet ujore në liqene, sipas specifikimeve teknike	1 copë	Pronësi ose me qira
Set mekanik, për riparim defektsh mjetesh pastrimi në sipërfaqet ujore.	1 set	Pronësi ose me qira
Jelek pune	7 copë	Pronësi ose me qira
Kaska/kapele mbrojtëse në punë	7 copë	Pronësi ose me qira
Thasë për mbledhjen/tërheqjen e mbeturinave nga sipërfaqet ujore (thasë të prodhuar enkas për mbetjet sipërfaqësore ujore, sipas përdorimit të makinave të pastrimit të sipërfaqeve ujore)	5 copë	Pronësi ose me qira
Këpucë të sigurimit kundër rrëshkitjes	7 copë	Pronësi ose me qira
Doreza pune	7 palë	Pronësi ose me qira
Kuti e ndihmës së shpejtë	2 copë	Pronësi ose me qira

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshëm), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (të vlefshme) duhet të shoqerohet me kontratën perkatëse të qerave/furnizimit, e lidhur para noterit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të paraqiten aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes apo cdo dokumentacion tjetër provues.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- Për mjetet teknike të pastrimit të mbetjeve nga sipërfaqet ujore, makinerine korrese në liqene të paraqitet dhe skeda teknike/ ose cdo dokumentacion që vërteton pajtueshmërinë e funksionit të saj me specifikimet teknike.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruar nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe makineria për pastrimi për sipërfaqet ujore në liqene nuk është e deklaruar nga operatori ekonomik në procedura të shpallura fitues.
- Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës përkatëse të DST, për të cilën duhet të paraqitet në tender një deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë ofertuese/personi i autorizuar.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronesi ose me qera me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

Shënim: kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE kualifikohet në vend të parë, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Numri dhe lloji i mjeteve është vendosur duke ju referuar zërave të shërbimit sipas specifikimeve teknike dhe kohëzgjatjes së shërbimit. Nëpërmjet përmbushjes së kapaciteteve teknike operatorët ekonomik vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Mjetet e kërkuara janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike. Numri i mjeteve që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në zërat e shërbimit.

Nga ana e AK vendosja e këtij kriteri është në përpjestim të drejtë më natyrën, zërat e shërbimeve dhe vlerën e kontratës.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike/termat e references janë hartuar duke u bazuar në parametrat e lejuara dhe sipas standardeve në fuqi, të cilat përbushin kërkesat dhe nevojat e AK nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike. Specifikimet teknike, për mallrat/shërbimet objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat/ shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38 dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Specifikimet teknike

Pastrim i basenit ujqor dhe sipërfaqes ujqore të Liqenit Artificial të Tiranës dhe Liqenit të

Farkës me një sipërfaqe totale prej 1.200.000 m²

Liqenet: Liqeni Artificial i Tiranës, 450.000 m²

Liqeni i Farkës, 750.000 m²

Pastrim i baseneve dhe sipërfaqeve ujqore të liqeneve objekt i kësaj procedure nga mbetjet, barërat dhe papastërtitë organike dhe jo organike me makineri korrëse të specializuar për procese të tilla pune.

Prerje e barërave (algave, leshterikëve, kallamave, etj) nën ujë në thellësinë deri në 1 metër, si dhe pastrimi i tyre nga sipërfaqja ujqore.

Grumbullim dhe mbledhja e papastërtive nënujqore nga thellësia e kërkuar dhe depozitimi i tyre në koshin e makinerisë, i cili duhet të ketë një kapacitet mbajtës jo më të vogël se 10 m³.

Transportieri i papastërtive të mbledhura në ujë duhet të jetë metalik, kjo me qëllim mbledhjen dhe depozitimin në koshin e makinerisë të të gjitha llojeve të mbeturinave të grumbulluara nga sipërfaqja ujqore si, barëra të këqija apo mbetje të tjera sipërfaqësore, kallamishte, kanaçe, mbetje të ndryshme, mbetje plastike, shkopinj, materiale drusore, etj.

Transportimin në breg të këtyre papastërtive dhe shkarkimin e tyre.

Materialet dhe produktet që do të përdoren nga makineria nuk duhet të ndotin sipërfaqen ujqore, furnizimi me karburant i saj duhet të bëhet vetëm në breg.

Makineria duhet të jetë bashkëkohore dhe e përshtatshme për korrjen dhe transportimin e mbetjeve sipërfaqësore, barit të ujit, si dhe e përshtatshme për të punuar në liqene.

Operatori ekonomik duhet të garantojë që gjatë procesit të punës do të mirëmbajë dhe riparojë çdo difektet të mundshëm që mund të shkaktohet gjatë realizimit të shërbimit.

Specifikimet teknike të makinerisë korrëse që do të përdoret në liqene:

1. Shpejtësia e lëvizjes 0 - 4 km/h

2. Lartësia e shkarkimit të jetë 0 – 3.5 metra
3. Thellësia e korrjes të jetë deri në 1 metër
4. Grumbullimi i papastërtive deri në thellësinë 1 metër
5. Kapaciteti i korrjes së makinës së pastrimit të mbetjeve sipërfaqësore, duhet të jetë jo më pak se 2000 m²/h
6. Kapaciteti mbajtës i depozitës së mbetjeve në bordin e makinerisë, të jetë jo më i vogël se 10 m³.